

**AIDA LAMAJ**

**VARIANTI DIALEKTOR, KRAHINOR DHE ARKAIK NË  
LIGJËRIMIN FEMËROR**

Ligjërimi femëror, si tërësia e fenomeneve gjuhësore specifike dhe karakterizuese e folësve të seksit femëror, në dialektet shqiptare haset vetëm si gjurmë sporadike.

Në pjesën më të madhe të studimeve dialektologjike dhe sociolinguistike dedikuar ndryshores gjini në dialektet shqiptare është mëtuar t'i përgjigjemi thjesht pyetjes nëse ligjërimi femëror është më konservativ sesa ligjërimi i burrave dhe rezultatet kanë qenë të ndryshme<sup>1</sup>. Terraçini (Terracini) dhe Useljo (Usseglio) kanë arritur në përfundimin se gratë janë më të shpejta sesa burrat për të pranuar dhe përcjellë risitë, por studiues të tjerë janë të mendimit se gratë hasin një lloj rezistence për të realizuar tingujt më tradicional të zonës dialektore apo besnikëri më të madhe të tyre ndaj të folmes lokale.<sup>2</sup> Megjithatë, ajo që mbetet e padiskutueshme është roli i madh i grave në procesin e transmetimit të ligjëritimit tek gjeneratat e tjera.

Prof. M. Domi shumë vite më parë e kishte parë të udhës të tërhiqte vëmendjen e studiuesve në drejtim të evidentimit dhe të përshkrimit të ndryshimeve dhe të zhvillimeve që po pësonte gjuha si pasojë e ndryshimeve historike nëpër të cilat po kalonte shoqëria shqiptare në përgjithësi dhe femrat në veçanti: "...probleme si natyra e së folmes së qyteteve tona, përgjithësisht të rritura me një ritëm të shpejtë pas çlirimit me banorë me prejardhje të ndryshme dhe proceset e lloj-llojshme gjuhësore që kanë ndodhur dhe po ndodhin në to, raportet midis ligjëritimit dialektor dhe gjuhës së folur popullore, "koinetë" e gjuhës së folur, përfundimet e kontakteve të ndryshme gjuhësore, ndërthurja dhe e elementeve letrare në njësitë e ndryshme dialektore të sotme, raportet midis njësisive të vogla dialektore dhe qendrave ekonomike e kulturore të tyre, gjuha e folklorit dhe ligjërimi dialektor e të tjera probleme kërkojnë një trajtim teorik të thelluar"<sup>3</sup> e duket se këto problematika mbeten aktuale dhe akoma më të mprehta edhe sot.

Në rrethanat e sotme gjuhësore, varianti dialektor shërben si një mjet tregues i përfaqësimit të vendit a krahinës nga është folësi shqiptar dhe repertori i ligjëritimit femëror nuk mund të mendohet pa variante të tilla. Në

---

<sup>1</sup> Gj. Shkurtaj, *Etnografi e të folurit shqip*, Tiranë, 2004, f. 242-243.

<sup>2</sup> Shih C. Grassi, A. Sobrero, *Fondamenti di dialettologia italiana*.

<sup>3</sup> M. Domi, *Dialektologjia shqiptare* 4, Tiranë, 1982, f. 7.

mbrujtjen dhe zhvillimin e këtyre varianteve kanë ndikuar faktorë ndryshëm social-politik e madje edhe fetar. Sipas M. Tototit në zonën e Kurveleshit “...ndërrimi i fesë pati si pasojë ndërprerjen e marrëdhënieve farefisnore dhe të krushqive me pjesën tjetër të mbetur të krishterë, gjë që solli një farë veçimi dhe mbylljeje në vetvete të këtyre grupeve me fe të ndryshme. Ky veçim u pasqyrua edhe në të folmen e tyre.”<sup>4</sup>

Në raport me varietetin standard, është interesant fakti që mes dy realizimeve gjuhësore, ndeshen tipare të përbashkëta. Ndikimi i tyre ka qenë i ndjeshëm sidomos në gjuhën e folur: “... nga të dy format e gjuhës letrare më e zbuluar dhe më e ndjeshme ndaj trysnisë së përditshme të dialekteve është forma e folur, sidomos ligjërimi bisedor”<sup>5</sup>. Standardi pasurohet prej lëndës së nevojshme që merr në leksik apo edhe në rrafsh të tjera. Disa elemente krahinore që e pasurojnë gjuhën letrare, iu nënshtrohen filtrave të saj, e të tjerë që janë nisur të hyjnë në derë, mbeten të rivlerësohen e ligjësohen<sup>6</sup> sepse “...një nga rrugët e pasurimit të leksikut të gjuhës letrare është hyrja e fjalëve dhe e shprehjeve që rrojnë në ligjërimin popullor ose në krijimtarinë gojore të popullit”<sup>7</sup>.

Në gjuhësinë shqiptare janë pranuar parametrat që i kanë hapur shtegun edhe folëseve femra të thyejnë kufijtë e ngushtë të të folmes<sup>8</sup>, duke mëtuar përvetësimin dhe përdorimin e fjalëve dhe shprehjeve nga gjuha letrare, nga të folmet e qyteteve etj. Kështu, gjallërimi i lëvizjeve, shkollimi e kulturimi, kontaktet e dendura me qytetin e me krahina të tjera, me punonjës të kualifikuar e mjetet e informacionit masiv i ka mundësuar seksit femëror përqafimin e më të përgjithshmes nga ana gjuhësore e kohore<sup>9</sup>. Për folëset e trevave të Jugut, një nga faktorët jashtëgjuhësor që ndikon më tepër në sjelljen gjuhësore femërore, është përndarja gjeografike a hapësinore.

Ligjërimi femëror dialektor a krahinor, i krahasuar me sistemin e përgjithshëm të gjuhës amtare, është një sistem i kufizuar si në përdorim ashtu edhe nga numri i përdoruesve. Edhe pse të gjithë anëtarët e kësaj bashkësie në mjedise të hapura, publike, kërkojnë të përdorin sa më shumë forma që i përkasin standardit, kërkojnë të shpalosin një model sa më të qytetëruar, koherent, modern (shpesh me një snobizëm që i bën të dalin jashtë kornizave të lejuara e të duken fals), kur ndodhen brenda familjeve e në mjedise të tjera

<sup>4</sup> M. Totoni, *Dialektologjia shqiptare* 1, Tiranë, 1971, f. 31-116.

<sup>5</sup> Jorgji Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1963, f. 120.

<sup>6</sup> Sh. Islamaj, *Gjuha, ligjërimi dhe fjala*, 19, Prishtinë, 2004.

<sup>7</sup> H. Shehu, *Fjalët dhe shprehjet e popullit – Burim i pashtershëm për pasurimin e leksikut të shqipes së sotme*, Gjuha jonë 2, Tiranë 1988, f. 47.

<sup>8</sup> J. Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë, 2001, f. 29.

<sup>9</sup> J. Thomai, vep. cit. po aty.

intime, përdorin nyjëtime, mjete dhe forma dialektore të veçanta. Kështu, përveç tipareve dialektologjike tipike të trevave të Jugut si:

- ruajtja e bashkëtingëllores “**h**” në fillim dhe në mes të fjalës (por në vitet e fundit vihet re shtimi i **h**-së edhe në fjalë që nuk e kanë: *harrij, hunazë, hezmer, Hamerikë* etj.);

- përdorimi i **rr**-së fortë;

- asimilimi i grupeve *mb, nd, ng, ngj*;

- ndërrimi i **ll**-së në **dh**;

- mbaresa “**e**” e shumësit të emrave mashkullorë;

- përdorimi i nyjës gjinore “**së**” në vend të “**te**” (*rrobat e atija së vdekurit, i thotë së gjadhit, i kam të së fëmijës* etj.);

- përdorimi i **ë**-së së theksuar para prapashtesës “**le**” (*dajkëlë, mesëlë* etj.)<sup>10</sup>;

tek ligjërimi femëror ne ndeshim:

• një temp më të shpejtuar të të folurit, d.m.th., femrës i nevojitet më pak kohë për të nyjësuar një frazë;

• përdorimin e **ë**-së së theksuar në vend të **e**-së;

• mospërdorimin i **r**-së së zbutur dhe zëvendësimin e saj me **rr** etj.;

• përdorimin më të dendur të emrave me **-ra**, p.sh.: *punëra, fjalëra, gatimera* etj.;

• formimin e shumësit të emrave me anë të metafonisë: *proka-proqe, bark-berqe, hardhi-herdhi, varg-vergje* etj.;

• ndërrimin e **r**-së në **l**-lë: *gjalpër -gjarpër, gërqele-gëlqere* etj.

Gratë nuk kursehen në përdorimin e pasthirrmave: *ah, aman hajmedet, obobo, oh, o lele, ububu* etj. apo të formave *mamazëza, motërzeza, tetezeza* etj., në përdorimin e tepruar të formave foljore të së kryerës së thjeshtë në vend të kohëve të tjera të së shkuarës, të shoqëruara me mbaresa të veçanta e sidomos me **-i** dhe **-ç** p.sh.: (unë) *i mblodhi, i gatoi, i foli, i qepi, i dhaç, e paç, thaç* etj.

Leksiku femëror dialektor, si produkt i një tradite të lashtë e i prirjeve pozitive të krijimeve të reja, me vlera ende të pazbuluara tërësisht<sup>11</sup>, me rrjedha sistemore interesante përbëhet kryesisht nga:

**a- fjalë me veçori fonetike dialektore:** *andër* (arnë), *brënda* (brenda), *koce, bilë* (vajzë), *kondo* (këmishë), *varem/xbres* (zbres), *ngjepem* (ngjitem), *cingris* (ngacmoj);

<sup>10</sup> M. Totoni, *Dialektologjia shqiptare 1*, 1971 f. 45-51 dhe M. Totoni, *Studime filologjike*, 1966, 1, f. 80 (në këto studime nuk trajtohet kalimi i **-së** në **-lë**).

<sup>11</sup> J. Thomai, vep. cit., f. 35.

**b- nga fjalë me veçori fjalëformuese e gramatikore:** (lozonjare, i mallkuar, pispillonj, qullamac, qurramash, rreckaman, sevdalli, vëllaço, vëllath etj.);

**c- fjalë me kuptime krahinore:** *citë* (shtizë), *çafkë* (kupëz për kafe), *kamare*, *shifon* (shami e zezë) etj.

Nga një vështrim i përgjithshëm vërejmë se vendin kryesor e zënë fjalët shënuese emra, mbiemra dhe folje.

Fushat leksikore e konceptore që lidhen më këtë lloj ligjërimi mund t'i ndajmë:

a) **Fusha e botës materiale**, karakteristikë për popullsinë e këtyre trevave që lidhet **me banesën e mjedisin rreth saj, me veglat e punës:** *avorua* (mur rrethues i shtëpisë), *bend* (hauz), *buhari* (oxhak), *dimërore* (dhomë ku rrinë njerëzit gjatë periudhës së dimrit), *dhogë* (dërrasë, nga kjo lind shprehja *bark i hapur në dhogë të mishit* – diçka që nuk durohet), *kallafe* (kosh prej thupre - kokëkallafe), *katoq* (kat i poshtëm i shtëpisë që nuk përdoret për të jetuar), *kosht* ose *barçe* (kopësht me perime), *kucur* (dru i trashë), *manxato* (kati i parë që banohet nga njerëz), *mashan* (lopatë e vogël për të marrë prush), *misorie* (dhomë pa dritare), *munxa* (kyç), *qipi* (mullar), *penxhere* (dritare), *sepet* (dollap, sënduk), *sergjen* (raft), *ganos* (kallais), *xhefk / xilefk* (lëkurë) *kofinë* (shportë), *shajka/peron* (gozhdë të vogla), *bushicë* (lëpushkë e misrit), *dhiminë* (mulli me ujë për të larë velenxat), *çatore / pënja* (kasolle pa mure), *muhul* (myk), *thiropull* (portë), *llanguriqe* (sende të vjetra), *fufut / tallazh* (mjet për të ndezur), *gazhere* (furnellë), *palldëm* (barku i kalit), *shila* (shkarpa), *xëq / xuk / xëc* (errësirë), *lumak* (fidan i ri i bimëve), *loshnik/cangadhe* (dele e vjetër), *bozhure* (mbeturina të kohës së vjeljes) etj.

b) **Fusha e botës materiale që lidhet me enët dhe mjetet e tjera** që përdor gruaja: *bragaç* (kusi), *çanak* (tas), *dhanar* (krehër për të krehur leshin), *ksestër* (qyp), *kuva* (kovë), *kuskë* (kusi e vogël), *luhare* (lugë e drunjtë), *magje* (govatë), *niro(h)it* (lavaman), *qepshe/ lufare* (garuzhde), *bakërre* (enë prej bakri - efekt i metonimisë), *cfungar* (sfungjer), *varkë* (dorezë e kuisë, një enë që qëndronte e varur në oxhak dhe ku gatuhej kryesisht trahana), *sahan* (tas), *lugë çobançe* (lugë e vogël prej druri), *karvane* (tepsi e madhe dhe e thellë), *pa(h)çavure* (peceta guzhine), *dori* (enë e stërgjatur me kapak) etj.

c) **Fusha e botës materiale që lidhet me rolin e femrës si amvisë:** *kopsidhe* (kafshatë e vogël), *brushtull / ngastër / laropit / qodhopitë / qollopitë* (gatim në tavë, kryesisht me lakra), *katmar / dhiplë* (petë të mbushura me arra), *mamace*<sup>12</sup> (pjesë brumi të ardhur prej miell misri), *thërrmokla djathi* (thërrime), *arme* (turshi), *gjizanik* (byrek), *mesnik* (byrek me mish), *larash* (byrek me lakra), *ormis*, *ujdis* (tregulloj, zbukuroj), *ëndë* (miell i skuqur), *pëlhurë* (grurë i zier), *sapllak* (garuzhde), *skupë* (fshesë), *mëdhë* (kafshatë) etj.

<sup>12</sup> Shih M. Totoni, *Vëzhgime për të folmen e Muzinës* në "Studime filologjike" 3, 1965, f. 101-124.

**d) Fusha e botës materiale që lidhet me veshjet:** *skutina* (rrobat e brendshme të fëmijës), *fuckato* (palë fustani), *llastika* (opinga), *grykole / gushore* (përparëse e vogël e fëmijëve), *mandile* (shami koke), *sheshla* (shapka), *sade* (fustan), *shifon* (*shami koke e zezë*), *vraka* (pantallona të leshta), *hindja* (copë, metrazhe), *peshti / amteri / anteri* (rrobat e para të bebes), *makat* (mbulesë), *punoj me citë* (me shtiza), *çember / anla* (pjesë e sipërme e divanit), *satamarkë* (rrobë e vogël grash), *kofin* (ujë me hi të kulluar që përdorej në vend të detergjentëve për të larë rrobat), *mallom/mballom* (arnë), *mësallë* (copë), *gjëlmitër* (lëmsh), *huja* (kordon me rruaza për shaminë e kokës), *huma/humai* (pëlhurë), *kortinaqe* (zbukurime për xhamat e dritareve), *magjëri* (vend ku mbahen ushqimet e dimrit), *dhambro/llambro* (temina), *nosimadhë* (aromë) etj.

**e) Fusha e fjalëve e shprehjeve që tregojnë marrëdhëniet familjare e farefisnore:** Është nga derë e parë; këndon kokoshi këtu; ku unë e ku ti; i paç të madhin e jo hadhin; është tjetër shkallë ajo; u bënë të gjithë si këmbët e dhisë; në çdo gjellë majdanoz (fut hundët kudo) etj.

**ë) Fusha e botës materiale që lidhet me sëmundjet:** *fëshnjir* (mendohet si një lloj verdhëze), *karkallo* - të zëntë karkalloja (kollë e mirë), *i zaskalisur* (i munduar), *frufi* (fruthi) etj.

**f) Fusha e fjalëve dhe e shprehjeve që lidhen me doket, zakonet, mendësinë e kulturën:** Ngreu, nuse, bëna zjarrë! Nuse, mos flaç me njeri, Më thot' nusja: ngreu kërce; ç' dëgjon në gjithëni, prite në shtëpi; u mësua në shtëpi si pula në mulli; dal për *siroqella / mazmallisem* (vij vërdallë kot), *lëshutem, spodhisem*, (rrezohem/pengohem), *kam andiri* (kam ndrojtje), *më bie llavra* (nevrikosem), *e rrahur në dhirinë / e vuajtur*; përçon si dashi kopenë, *bëj maqili ose maqilis* (bëj lëmsh, ngatërroj) etj.

**g) fusha e ndikimeve gjuhësore të botës fetare:** *babashë, bën duva, hamile* – shtatëzanë, *meshë, rrahmet* (rahmet pastë!), *mulla, kuran, nuskë, perëndi* (shyqyr, moj perëndi), *qabë, xhenet, xhehnem, uratë, teslim, makafa* (pjesa që ndahet për të nderuar të vdekurit), *thevap/sevap, xhenaze* (i vdekuri) etj.

**gj) fusha e fjalëve dhe e shprehjeve që lidhen me vlerësimin për karakteristikat fizike dhe karakteriale të njeriut:** *xhahilë/noprane* (kokëfortë), *kushullë* (grua e bukur), *muamele* (njeri që ngjitet nga pas), *katërzhik* (zonjë), *mëzmëze* (mistrece), *çallëstjare/çalltis* (shumë e zonja, që çan e ndan), *kokëshinik* (tekanjoz), *torjar* (njeri i shkathët, *derrjare* (nga një fis jo i mirë – nga *palofis*)<sup>13</sup>, *sumbull* (e bukur), *lastonj* (e gjatë dhe e hollë), *llabane* (e shkurtër dhe e shëndoshë), *xhydylere* (e djallëzuar), *baktan* (hedh të ligat), *beronjë* (grua që nuk lind), *drënjë* (e fortë fizikisht), *xuqe* (plakë), *derbedere* (jetime), *cinxur/cinxuris* (i shkathët) etj.

Pavarësisht se sa shumë ose pak prestigj u krijon njerëzve ligjërimi (mënyra e të folurit), variantet dialektore, krahinore a arkaike përbëjnë shpesh

<sup>13</sup> *Palo* – përdoret dendur në trevat e Jugut, si në popullsinë e besimit të krishterë ashtu edhe mysliman, si parashtesë me kuptim përkeqësues.

një pasuri të paçmueshme për shkrimtarin e letërsisë artistike që mund të vjelë këtu elementët e nevojshëm për të konkretizuar a pikturuar personazhe ose ambiente tipike të kësaj zone për të krijuar atmosferën dhe shijen e trevave të Jugut.

Në strategjinë e ligjërimit femëror kapërcehen shpesh kufijtë e të menduarit objektiv. Folëset-femra<sup>14</sup> kërkojnë me ngulm t'i shprehin emocionet, duke projektuar personalitetin e vet ose ndikimin tek të tjerët. Kështu, gjatë ligjërimit afektiv, sipas ndryshoreve moshë, nivel arsimimi, mund të kuptojmë më mirë përdorimin a mospërdorimin e shpesh të varianteve dialektore e krahinore. Në brezin e vjetër i ndeshim më shpesh fjalët dhe shprehjet dialektore. Përpjekjet për t'iu qasur standardit janë të një shkalle të papërfillshme e situative, sepse shumica e këtyre femrave janë të pashkolluara dhe as që i njohin format korresponduese në standard, madje ato as që nuk binden se forma që ato përdorin është një formë që ka përdorim të kufizuar gjeografik dhe me fanatizëm e mbrojnë variantin e tyre duke thënë shpesh: "ne kështu i themi!"

Ligjërimi i grave të moshës së mesme paraqitet më ndryshe. Ato më të shkolluarat arrijnë deri diku t'i dallojnë format dialektore nga ato standarde e sidomos, nëse janë të punësuar, ato e përshtasin sjelljen gjuhësore me situatat dhe bashkëbiseduesit e tyre.

Gratë shtëpiake janë më konservatore ndaj formave dialektore dhe pikërisht në këto familje, brezi më i ri trashëgon një numër më të madh fjalësh të tilla edhe pse është pikërisht ky brez i ri që është më i hapur ndaj standardit dhe risive. Adoleshentet e të rejat "i thithin" format dialektore nga modeli familjar a krahinor, por nuk preferojnë t'i përdorin, sepse u vjen turp dhe e quajnë prapambetje një mënyrë të tillë të të folurit. Mund të themi se përdorimi i varianteve dialektore, rajonale e krahinore shërben më së shumti si mjeti më frytdhënës për të arritur konformizëm në gjuhë.

Mënyrat e të shprehurit femëror janë modernizuar në vitet e fundit të shekullit XX dhe me fillimin e shekullit të Ri. Lëvizjet demografike (në Jug) nga zonat rurale në zonat urbane, ku ka qendra universitare, përfaqësojnë një simbiozë ekonomike, shoqërore e kulturore. Shumë individë e familje kanë emigruar brenda vendit. Gratë shqiptare sipas profesionit e mundësive, pushtetmbajtëse ose si pjesë e familjeve shqiptare të trevave të Jugut, kanë lëvizur nga fshatrat në qytete si Gjirokastra, Saranda, Përmeti, Vlora e sidomos në Tiranë. Duke qenë përballë risive kulturore e shoqërore, femrat janë munduar t'i përshtaten modeleve që gjejnë në vendet ku shkojnë e, për pasojë, rezultati është bjerrja e shumë formave që kanë shërbyer më parë si mjeti më i mirë për të shprehur mendimet, ndjenjat, shqetësimet e tyre. Jo

<sup>14</sup> M. Bejtja, *Ligjërimi afektiv dhe përdorimi i fjalëve të huaja*, në Seminarin XX ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 2002, f. 361.

rrallë, madje edhe në mjediset e Universitetit të Gjirokastrës, ka studente që mundohen t'u largohen vetëdijshëm formave e leksemave të trevave nga vijnë e të kërkojnë realizime e ndërkëmbime gjuhësore që i afrojnë me standardin, për të shmangur ndjenjën e inferioritetit në këtë mjedis të ri.

Pavarësisht zhvillimeve të fundit që e kanë përfshirë gjuhën shqipe, dhe prirjeve drejt globalizimit, jo vetëm në fushën ekonomike dhe kulturore por edhe në atë gjuhësore, elementet dialektore, krahinore dhe arkaike mbeten pjesë e krenarisë tonë për veçanësinë e tyre sepse siç ka pohuar prof. J. Thomai: “Fjala shqipe është një nga krijesat e pavdekshme të popullit, e cila duke i kapërcyer shekujt, ka hyrë në kohën tonë më e pastër e më e fuqishme, sepse në të krijuesi i madh ka vënë dorën e dashurinë e vet”<sup>15</sup>.

#### BIBLIOGRAFI

- Bejtja, M., *Ligjërimi afektiv dhe përdorimi i fjalëve të huaja*, në Seminarin XX ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, 361. Prishtinë, 2002.
- Domi, M., *Dialektologjia shqiptare*, 4, 1982.
- Grassi, C. Sobrero, A. *Fondamenti di dialettologia italiana*, Laterza, 2005.
- Islamaj, Sh., *Gjuha, ligjërimi dhe fjala*, 19, Prishtinë, 2004.
- Gjinari, J., *Dialektologjia shqiptare*, 1970.
- Lirika popullore* 1, 2, 3, 4.
- Shehu, H., *Fjalët dhe shprehjet e popullit – Burim i pashtershëm për pasurimin e leksikut të shqipes së sotme në Gjuha jonë*, Tiranë, 1988, 2.
- Shkurtaj, Gj., *Etнологи e të folurit shqip*.
- Totoni, M., *Dialektologjia shqiptare* 1, 1971.
- Totoni, M., *Vëzhgime rreth të folmes së qytetit të Gjirokastrës në “Studime filologjike”*, 1, 1966.
- Totoni, M., *Vëzhgime për të folmen e Muzinës në “Studime filologjike”* 3, 1965.
- Thomai, J., *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, 29. Tiranë, 2001.

---

<sup>15</sup> J. Thomai, vep. cit., f. 238.

